

Hulumtim: Mishi i Brazilit në tregun e Maqedonisë

Mishi kontrabandohet edhe me kuaj

ANILA LIMANI

Shkup - Mishi i Brazilit hyn në Maqedoni, nëpërmjet vendkalimeve kufitare, në sy të doganierëve, por ka edhe raste kur tregtia me këtë mish bëhet edhe nëpërmjet malit, me kuaj të ngarkuar me mish. Më pas ky lloj mishi përfundon nëpër kuzhinat e restoranteve të ndryshme, si dhe në tezgat e tregjeve të gjelbërta, ku nuk ka asnjë lloj kushti higjieno sanitar. Nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) sqarohet se policia ka arritur të sekuestrojë 7 tonë e 925 kilogram mish me prejardhje nga Brazili, i cili në mënyrë ilegale ka tentuar të hyjë në Maqedoni, si dhe ka ngrit tre padi penale ndaj tre personave. Njëri prej rasteve është shumë interesant, ku gjashtë kuaj të ngarkuar me nga 150 kilogram mish janë zënë në afërsi të fshatit Bllacë të Shkupit. Personat që shoqëronin kuajt (tre) kanë ikur, ndërsa kuajt e ngarkuar me mish Brazili janë zënë nga policia. "Në lidhje me rastet e zbuluara të tregtisë ilegale me mish Brazili në territorin e Maqedonisë në periudhën nga viti 2007 deri në 2009 janë vërejtur rastet e mëposhtme: Gjatë vitit 2007 në kuadër të aktiviteteve për zbulimin dhe ndalimin e lëshimit në treg të prodhimeve ushqimore pa dokumentacion janë zbuluar dy raste të kontrabandës me mish, ku gjithsej janë sekuestruar 6 ton e 875 kilogram mish. Në rastin e parë në afërsi të fshatit Banjani të Shkupit në automjet transporti me targa të Kosovës në të cilën udhëtonin tre persona nga Shkupi janë gjetur 6 ton mish i ngrirë pa dokumentacion me prejardhje nga Brazili, të dedikuara për shitje në tregun tonë", sqaron zëdhënësi i MPB-së, Ivo Kotevski. MPB-ja ka ndrit padi penale ndaj një personi për

veprën penale fshehje malli që janë lëndë e kontrabandës dhe mashtrimit doganor në bazë të nenit 278 të ligjin penal të Republikës së Maqedonisë. "Në rastin e dytë në Kumanovë gjatë kontrollit të industrisë së mishit janë gjetur dhe sekuestruar 875 kilogram mish deri të ndrirë me prejardhje nga Brazili pa dokumentacion. MPB ngriti padi penale ndaj dy personave nga Shkupi për veprën penale fshehje malli që janë lëndë e kontra-



bandës dhe mashtrimit doganor në bazë të nenit 278 të ligjin penal të republikës së Maqedonisë", thotë Kotevski. Ai sqaron se gjatë vitit 2008 është zbuluar një rast kontrabande me mish, ku janë sekuestruar 1 050 kilogram mish Brazili. "Rasti është zbuluar në prill të vitit 2008 në afërsi të fshatit Bllacë të Shkupit. Gjatë tentimit për të hyrë në mënyrë ilegale në Maqedoni janë vërejtur tre persona të panjohur me 6 kuaj të ngarkuar, në përpjekje për të kontrabanduar 1 ton e 50 kilogram mish me prejardhje nga Brazili. Pasi u është dhënë urdhër që të ndalojnë personat e panjohur janë larguar në drejtim të Kosovës, është gjetur mishi i cili është dorëzuar në Inspektoratin për veterinarin në Shkup. Deri në prill të vitit 2009 nuk është zbulu-

ar asnjë rast i tregtisë ilegale me mish Brazili", tha Kotevski.

Janë dënuar vetëm 3 doganier

Sipas të dhënave të drejtorisë së Doganave, vetëm 3 doganier gjatë tre viteve të fundit janë dënuar për implikim në tregtinë me mish Brazili. "Nga ana e Sektorit për përgjegjësi profesionale është përpunuar padi penale më 31 dhjetor të 2007-ës kundër shërbësve doganorë me initiale T.U, R.T dhe G.P për vepër penale

shkruar nga drejtori Vanço Kargov. Ndërkaq, për vitin 2008 dhe 2009 nuk është dënuar asnjë doganier, apo punonjës i doganave. Po ashtu Drejtoria e doganave në kuadër të ingerencave të saj ka kryer veprimtari hetuese, drejtuar personave juridik, importues të këtyre mallrave. "Në bazë të dëshmime të siguruar, Sektori për kontrolle dhe hetime gjatë periudhës 2006- 2007 ngriti tri padi penale për dyshime se kanë kryer veprën penale mashtrim doganor kundra: 1. në vitin 2006 kundra personit juridik 'ERMA DOOEL' nga fshati Likovë dhe personave fizik J.E., Zh.I., S.N. dhe A.M. Janë të bazuara dyshimet se procedura e filluar transite nuk është e përfunduar për mishin e lopëve në sasi prej 29.170 kilogram, pas asaj vlere nga të dalat e ikura arrin vlerën 323.011,00 denarë. 2. Në vitin 2007 është ngrit padi kundër personit juridik POVER TRANS nga Shkupi dhe personit H.B, personi juridik DTSHUTU SIMAKS SHPK nga Shkupi dhe personat M.S dhe XH.S. Njëherësh, procedura e filluar transite nuk është e përfunduar për mishin e pulës me prejardhje nga Brazili në sasi prej 102.932 kilogramëve, dhe për këtë vlere nga të dalat e ikura arrin 1.312.672,00 denarë", sqarohet nga Drejtoria e Doganave. Sipas tyre të gjitha angazhimet e Drejtorisë Doganore janë drejtuar në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, transparencës në punë dhe aplikimin e drejtë të procedurave ligjore. (vazhdon)

Kjo storje është realizuar me mbështetjen e SCOOP dhe Shoqatës Daneze për Gazetari Hulumtuese

keqpërdorim i detyrës dhe autorizimit zyrtar, e cila është e dorëzuar deri ne Prokuroria themelore publike në Shkup. Duke siguruar dëshmi zyrtare dyshimet e bazuara të saj, se zyrtarë doganorë në mënyrë fiktive duke mbyllur 4 procedura transite në RD Bllacë, të cilat kanë të bëjnë me 103 tonë mish pule bruto nga Brazili, e kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare duke lejuar e njëjta të mbetet në njësinë doganore të Republikës së Maqedonisë dhe njëkohësisht kanë lejuar kompania e transportuesit të mallrave dhe shpedicioni i autorizuar të dënohen për shfrytëzim kundërligjor pronësor në vlerë prej 1.312.672,00 denarë", thuhet në përgjigjen e Drejtorisë së Doganave, nën-